



Prishtinë: 09.02.2017

Kodi i ZRRE-së: V_887_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1547_12_16**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **19.01.2017**

në seancën e mbajtur më datë 09.02.2017, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I.R. nga Ferizaj me shifër të konsumatorit: DFE 13518 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1548_12_16 i datës 05.12.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 19.01.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i datës 24.07.2015 është bërë në përputhje me rregullat në fuqi pasi që energjia e harxhuar nga konsumatori nuk është regjistruar për 33% por që janë regjistruar vetëm 66% e energjisë së shpenzuar.

Gjithashtu përfaqësuesi i KESCO-së në ankesë ka theksuar se njehsori me numër 4308195 nuk është trajtuar si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike por që humbja e energjisë elektrike është faturuar përmes korrigjimit të bërë për gjashtë muajt e fundit të njehsorit i cili nuk ka matur saktë energji elektrike.

Në ankesën e KESCO theksohet se ZRRE arsyetimin e saj e mbështet plotësisht në rrjedhën e energjisë elektrike duke bërë krahasimin me njehsor të ri dhe njehsor të vjetër por që sipas KESCO – së në raste të ndërrimit të njehsorit elektrik konsumatori mund të bëjë largimin/ndërrimin e pajisjeve me qëllim të zvogëlimit të konsumit të energjisë elektrike, gjithashtu në ankesë theksohet se është një tendencë e përgjithshme e konsumatorëve që në momentin e ndërrimit të njehsorit nga analog në digjital, konsumi të jetë më i vogël. Gjithashtu në ankesë është kërkuar që Bordi i ZRRE-së ta pezullojë vendimin e DMK-së me nr. ZRRE/DMK_V_1548_12_16.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me konstatimet e theksuara në ankesë nga ana e KESCO-së se njehsori elektrik për shkak të defekteve teknike ka matur energji elektrike për 33.33% më pakë se sa shpenzimi real që është bërë në pikën matëse, Bordi i ZRRE-së ka analizuar në detaje konstatimet e theksuara në procesverbalet e laboratorit nga qendra e kalibrimit por që ky konstatim nuk është treguar bindës pasi që të gjitha analizat tjera të shpenzimit të energjisë si rrjedha e energjisë aktive dhe procesverbale tjera nuk e dëshmojnë argumentet e dhëna nga laboratorit i kalibrimit pasi që përkundër gjithë këtyre konstatimeve konsumatori ka një mesatare të shpenzimit konstant krahasuar shpenzimin me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e përgjithshëm të energjisë elektrike dhe ka konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Po ashtu është vërejtur se konsumatori edhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik me nr. 4308195 nuk ka dallim në shpenzimin e energjisë elektrike krahasuar me shpenzimet e më hershme, si dhe me shpenzimet e tanishme të regjistruara në njehsorin e ri elektrik nr. 64095843. Të dhënat nga rrjedha e energjisë elektrike tregojnë se mesatarja mujore e shpenzimeve për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik nr. **34308195** për periudhën **01/2015** deri në periudhën **06/2015** është **601 kWh/muaj**, si dhe për periudhën e më hershme **01/2014** deri në periudhën **06/2014** është **531 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr. **64095843** mesatarja e shpenzimeve për periudhën e njëjtë kohore **01/2016** deri në **06/2016** është **593 kWh/muaj**.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike

Bordi ka analizuar edhe konstatimin e KESCO-së të theksuar në ankesë se njehsori me numër 4308195 nuk është trajtuar si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike por që humbja e energjisë elektrike është faturuar përmes korigjimit të bërë për gjashtë muajt e fundit të njehsorit i cili nuk ka matur saktë energji elektrike. Lidhur me këtë Bordi ka konstatuar se në rastin konkret nuk kemi vërejtur ndonjë element të shfrytëzimit të energjisë elektrike përmes manipulimit në njehsorin elektrik duke u bazuar në provat tjera që ndërlidhen me ankesën e konsumatorit.

Bordi gjithashtu ka konstatuar se lidhur me gjetjet e evidentuara nga qendra e kalibrimit për humbje të energjisë elektrike prej 33.33% më pak se sa energjia që është shpenzuar nuk qëndrojnë për faktin se duke u bazuar në analizat e rrjedhës së energjisë elektrike të theksuara në këtë vendim tregojnë një pasqyrë tjetër të shpenzimit të pikës matëse gjë për të cilën Bordi nuk ia ka falur besimin procesverbalit të kalibrimit. Për më tepër për këtë çështje Bordi është mbështetur edhe në dispozitat e procedurës për identifikimin dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ku theksohet se: Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së ,
- Konsumatorit I.R, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.